



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenin 4 paragrafi 3 dhe nenin 81 paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit 05/L-45 për Sigurime (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 2016 miratoi:

RREGULLORE PËR PUBLIKIMIN E INFORMACIONIT NGA SIGURUESIT

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë informacionin që siguruesit duhet të publikojnë, mënyrën, formën dhe afatet kohore për publikimin e tij, në funksion të rritjes së transparencës dhe disiplinës në sektorin e sigurimeve, si dhe për të siguruar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e këtij sektori.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjithë siguruesit e licencuar nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha përkufizimet e përdorura në këtë rregullore janë përcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-45 për Sigurimet (tutje: *Ligji për sigurimet*) dhe/ose siç përcaktohet më tutje për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - a) *Viti financiar* - nënkupton periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor të atij viti.

Neni 3

Kërkesat për procedurat e publikimit dhe karakteristikat e informacionit

1. Siguruesit duhet të hartojnë dhe të aprovojnë akte të brendshme për procedurat e përgatitjes dhe publikimit të informacionit, të cilat duhet të përmbajnë llojin e informacionit për publikim, frekuencën e publikimit dhe sistemet e kontrollit në procesin e publikimit.
2. Siguruesit duhet të publikojnë informacion mbi rreziqet ndaj të cilave ekspozohen në veprimtarinë e tyre, duke dhënë një pamje të përgjithshme të profilit të rrezikut.
3. Informacioni i publikuar nga Siguruesit duhet të jetë i natyrës materiale, që t'i përshtatet dhe shërbejë kërkesave vendimmarrëse të përdoruesve të tij dhe t'i ndihmojë ata në

vlerësimin e rreziqeve dhe fitimeve të pritshme të investimeve të tyre, të ekspozimeve të tjera të mundshme ose të performancës dhe të gjendjes financiare të ardhshme të veprimitarisë së tyre.

4. Sipas kësaj Rregulloreje, informacioni do të konsiderohet i natyrës materiale në rastet kur përjashtimi ose deklarimi i tij i gabuar, mund të ndikojë ose të ndryshojë vendimin ekonomik të përdoruesit të këtij informacioni.
5. Siguruesit duhet të publikojnë informacion të besueshëm që reflekton gjendjen financiare të tyre. Ky informacion duhet të jetë i verifikueshëm në çdo kohë, i plotë në të gjitha aspektet që paraqesin rëndësi për përdoruesin.
6. Siguruesit duhet të paraqesin datën e publikimit të informacionit. Në raste të korrigjimit të informacionit të publikuar nga siguruesit, ato duhet të publikojnë edhe datën e korrigjimeve të bëra.
7. Siguruesit duhet të përdorin logon e vet, si shenjë dalluese në publikimet e tyre.
8. Siguruesit nuk duhet të publikojnë informacione, të cilat konsiderohen konfidenciale ose sekrete për klientët e tyre në bazë të ligjeve apo akteve nënligjore të aplikueshme ose informacione të tjera të cilat mund të kenë ndikim në pozitën konkurruese të tyre në treg.
9. Siguruesit duhet të publikojnë informacionin në njërën nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës si dhe mbi baza vullnetare edhe në gjuhë të tjera.

Neni 4

Publikimi i raporteve vjetore

1. Siguruesi duhet të përgatitë dhe publikojë raportin vjetor të audituar të miratuar nga bordi drejtues i siguruesit, jo më vonë se 6 muaj nga përfundimi i vitit kalendarik.
2. Raporti vjetor duhet të përmbajë:
 - a) pasqyrat financiare të audituara;
 - b) opinionin e auditorit të jashtëm mbi pasqyrat financiare;
 - c) opinionin e aktuarit të pavarur, të angazhuar nga auditori i jashtëm për qëllime auditimi.
3. Siguruesi duhet që raportet vjetore t'i mbaj të publikuara në faqen e internetit për së paku tre vitet e fundit financiare.
4. Përveç, siç përcaktohet me paragrafin 2 të këtij neni, siguruesit në raportet e tyre vjetore duhet të shpalosin si në vijim:
 - a) Të dhënat e përgjithshme mbi siguruesin, të cilat së paku duhet të përshijnë:
 - i. emrin e siguruesit dhe adresën e zyrave kryesore;
 - ii. emrin paraprak të siguruesit (nëse aplikohet);
 - iii. në qoftë se siguruesi i përket grupit, emrin e grupit organizativ, degët kryesore dhe pjesëmarrësit;
 - iv. shtrirjen territoriale të siguruesit (degë, filiale, zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit);

- v. datën e themelimit të siguruesit dhe statusin ligjor;
 - vi. emrat e funksionarëve kyç, siç janë: anëtarët e bordit, menaxhmenti i lartë, personat kyç në funksionin e kontrollit (nëse aplikohet, menaxherët e riskut, zyrtarët e pajtueshmërisë, auditorët e brendshëm dhe aktuarët);
 - vii. emrat dhe adresat e auditorëve të jashtëm dhe aktuarëve;
 - viii. të dhënat mbi kontaktet;
 - ix. klasat e sigurimit për të cilat është i licencuar.
- b) Të dhënat mbi strukturën e kapitalit dhe aksionarët, listën e aksionarëve dhe pjesëmarrjen sipas përqindjes në kapitalin aksionar;
 - c) Objektivat, politikat dhe menaxhmentin;
 - d) Qeverisjen korporative;
 - e) Politikat e menaxhimit të rrezikut;
 - f) Të dhënat lidhur me performancën dhe gjendjen financiare, të cilat së paku duhet të përfshijnë:
 - i. Pozicionin financiar (Bilancin e gjendjes);
 - ii. Performancën financiare (Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve);
 - iii. Mjaftueshmërinë e kapitalit (Aftësinë paguese);
 - iv. Shpalosjen e kontratave dhe marrëveshjeve me Risiguruesit për rreziqet e ceduara;
 - v. Të dhënat mbi primet dhe dëmet sipas klasave të sigurimeve në numër dhe vlerë;
 - vi. Treguesit (raportet) bazë të sigurimeve, siç janë: raporti i dëmeve të ndodhura, raporti i shpenzimeve, raporti i kombinuar, raporti operativ, raporti i dëmeve të rregulluara, raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, raporti bruto dhe neto i rrezikut;
 - vii. Treguesit (raportet) e tjera financiare siç janë: treguesi i kthimit në mjetet mesatare, treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar, treguesi i kthimit nga investimet mesatare, treguesi i borxhit ndaj ekuitetit.
5. Informacioni që përfshihet në paragrafin 2 të këtij neni duhet të paraqitet qartë dhe në mënyrë të përshtatshme, me qëllim që të arrihet një nivel i mjaftueshëm i transparencës së siguruesit.
 6. Siguruesit duhet të dorëzojnë një kopje të raportit të tyre vjetor në BQK dhe ta publikojnë atë në faqen e tyre të internetit.
 7. Informacioni i kërkuar në paragrafin 4, pika a) të këtij neni duhet të jetë i publikuar në çdo kohë në faqen e internetit të siguruesit dhe duhet të rifreskohet sa herë që ka ndryshime.

Neni 5

Publikimet tremujore

1. Siguruesit duhet të publikojnë pozicionin financiar dhe performancën financiare në faqen e tyre të internetit brenda 30 ditëve nga përfundimi i secilit tremujori, sipas shtojcave të paraqitura në këtë rregullore.

2. Përmbledhja e publikuar tremujore e pozicionit financiar dhe performancës financiare duhet të jetë e saktë, e vërtetë dhe të jetë në përputhje me përmbledhjen e periudhës së mëparshme, e cila duhet të përfshihet si referencë. Në rast të ndryshimit të metodave të aplikuara të kontabilitetit, projeksionet e periudhës së mëparshme duhet të përcaktohen dhe publikohen në pajtim me metodat e reja.
3. Përmbledhja preliminare e bilancit të gjendjes dhe pasqyrës së të ardhurave për tremujorin e katërt, që përfundon më 31 dhjetor, duhet të publikohet brenda 30 ditëve pa pritur opinionin e auditorëve të jashtëm, pa cenuar obligimin për të publikuar bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave përfundimtare të audituara brenda 6 muajve pas përfundimit të vitit financiar së bashku me opinionin e auditorit të jashtëm.
4. Bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të ardhurave duhet të përpilohen sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, duke pasqyruar rregullat dhe standardet shtesë të përcaktuara nga BQK-ja dhe të publikohen në pajtim me formularët e bashkangjitur në fund të kësaj rregulloreje.
5. Siguruesit, përveç bilancit të gjendjes dhe pasqyrës së të ardhurave, gjithashtu duhet të publikojnë në faqet e tyre zyrtare të internetit në baza tremujore edhe treguesit e përcaktuar nën 4, paragrafi 4, nën paragrafi f) të kësaj rregulloreje.

Neni 6 **Informimi i publikut**

Për qëllime të informimit të publikut, siguruesit duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit, informacionet sikurse përcaktohet me nenin 53 të Ligjit për Sigurimet.

Neni 7 **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Shkeljet ndaj kësaj rregulloreje do të jenë subjekt i masave përmirësuese dhe dënimeve të parapara me nenet 124, 125 dhe 126 të Ligjit për Sigurimet.

Neni 8 **Shtojcat**

Pjesë përbërëse e kësaj rregullore është edhe aneksi 1 me tabelat e bashkangjitura.

Neni 9 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi me 1 korrik 2016.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Prof. Dr. Bedri Peci

Aneksi 1

BILANCI I GJENDJES

Euro '000

ASETET	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Paraja në dorë dhe në bankë		
Investimet në depozita		
Kostot e përvetësuara të shtyra		
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet dhe risigurimet		
Asetet e risigurimit		
Tokë dhe Ndërtesa		
Asete të tjera të prekshme		
Asetet e paprekshme		
Asetetë tjera		
GJITHSEJ ASETET		
DETYRIMET		
Provizionet për dëme dhe shpenzimet e trajtimit të dëmeve		
Provizionet për primin e pa fituar dhe riskun e pa skaduar		
Llogaritë e pagueshme të sigurimit dhe detyrimet e tjera		
Huatë dhe kreditë		
Kreditorët e tjerë dhe Akrualet		
GJITHSEJ DETYRIMET		
KAPITALI AKSIONAR		
Kapitali aksionar		
Fitimi i akumuluar		
Rezerva të tjera		
GJITHSEJ KAPITALI AKSIONAR		
GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI		

PASQYRA E TË ARDHURAVE

Euro '000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Primi i fituar, neto nga risigurimi		
Primi i shkruar bruto		
Primi i ceduar në risigurim (-)		
Ndryshimi në primin e pafituar (+/-)		
Ndryshimi në primin e pafituar, pjesa e risigurimit (+/-)		
Të hyrat e fituara nga interesi, neto		
Të hyrat e tjera		
Gjithsej të hyrat		
Humbjet e ndodhura, neto nga risigurimi		
Dëmet e paguara bruto		
Pjesa e risiguresit (-)		
Ndryshimi në rezerva për dëme		
Pjesa e risiguresit (-)		
Shpenzimet e marrjes në sigurim		
Ndryshimi në shpenzimet e marrjes në sigurim (+/-)		
Shpenzimet administrative		
Komisionet e risigurimit (-)		
Gjithsej humbjet dhe shpenzimet		
Fitimi /humbja neto për vitin		
Të hyra të tjera gjithëpërfshirëse		
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse për vitin		

- Treguesi i kthimit në mjetet mesatare = $\text{Fitimi neto} / \text{mjetet mesatare}$
- Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar = $\text{Fitimi neto} / \text{ekuiteti mesatar}$
- Treguesi i kthimit në investimet mesatare = $\text{Të hyrat e fituara nga investimet} / \text{asetet mesatare të investuara}$
- Treguesi i borxhit ndaj ekuiteti = $\text{Gjithsej Detyrimet} / \text{kapitali aksionar}$
- Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit = $\text{Kapitali në dispozicion} / \text{kapitali rregullator i kërkuar}$.